

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7881
E enjte, 12 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Spiropali shpreh gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë në fushën e parlamentarizmit | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NGRIHET AKTAKUZË NDAJ 45 PERSONAVE PËR SULMIN NË BANJSKË, NË MESIN E TYRE EDHE RADOIÇIQI | FAQE 4-5




Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave në rastin e sulmit terrorist që ndodhi vitin e kaluar në Banjskë. Në mesin e personave që është ngritur aktakuzë është edhe Milan Radoiçiqi. Të

përfshirët, sipas prokurorit të rastit, Naim Abazi, kanë pasur role të ndryshme brenda grupit të tyre kriminal, "duke filluar nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri te financimi dhe shpëlarja e parave".

"Në mesin e të akuzuarve kryesorë është edhe individi me pozitë kyçe si udhëheqës i grupit, Millan Radoiçiq, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në koordinimin dhe veprimtarinë kriminale", tha Abazi

AKTUALE



HARRISI DHE TRUMPI KRITIKOJNË ASHPËR QËNDRIMET POLITIKE TË NJËRI-TJETRIT NË DEBATIN E PARË | F. 2

KURTI BËN HOMAZHE NË PËRKUJTIM TË VIKTIMAVE TË 11 SHTATORIT 2001 | F. 6

RAMA TAKON DREJTORIN E POLICISË PËR RAJONIN E PRISHTINËS, DISKUTOJNË PËR SITUATËN E SIGURISË NË KRYEQYTET | F. 7

EKONOMI



HARADINAJ: I ÇUDITSHËM DHE KREJT I PAKUPTIMTË LAVDËRIMI I KURTIT PËR KEK-UN DHE SUKSESET E TIJ | F. 8

BEKIM HOXHA EMËROHET DREJTOR I AUV-it | F. 8

SPORT



SYLVINHO: KJO HUMBJE NUK NDRYSHON OBJEKTIVAT TONA | F. 10

ISH-MINISTRI HASANI: FALË ATYRE DJEMVE ÇLIRIMTARË QË JANË NË HAGË, KURTI GËZON POZITËN E KRYEMINISTRIT | F. 3



QEVERIA MIRATON NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR BYRONË PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME | F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Harrisi dhe Trumpi kritikojnë ashpër qëndrimet politike të njëri-tjetrit në debatin e parë

WASHINGTON, 11 SHTATOR - Debati i parë në mes të kandidatës demokrate për presidente Kamala Harris dhe rivalit të saj republikan Donald Trump u shoqërua me polemika luftarake mbi ekonominë, emigracionin, abortin, kujdesin shëndetësor dhe politikën e jashtme.

Nënpresidentja Harris, 59 vjeçe, kritikoi synimin e Trumpit për të vendosur tarifa të larta ndaj mallrave të huaja, një propozim që ajo tha se do të ishte një taksë për klasën e mesme, ndërsa foli mbi planin e saj për të ofruar përfitime tatimore për familjet amerikane dhe bizneset e vogla. "Donald Trump na la nivelin më të ulët të punësimit që nga Depresioni i Madh (rënia e madhe ekonomike në Shtetet e Bashkuara e viteve 1930)", tha Harris, duke iu referuar viteve të tij si president nga viti 2017 deri në vitin 2021. Niveli i papunësisë arriti kulmin në 14.8% në prill të vitit 2020 dhe ra në 6.4% kur ai u largua nga detyra.

Trump, 78 vjeç, kritikoi Harrisin për inflacionin e lartë gjatë mandatit të administratës së presidentit Biden, megjithëse ai e mbivlerësoi nivelin e rritjes së çmimeve. Ai, gjithashtu, iu drejtua shpejt çështjes së tij kryesore, emigracionit, duke pretenduar përsëri pa prova se emigrantët nga "azilet e të çmendurve" po kalojnë kufirin jugor të Shteteve të Bashkuara me Meksikën. Inflacioni, tha ai, "ka qenë një katastrofë për njerëzit, për klasën e mesme dhe gjithë të tjerët".

Debati filloi me një shtrëngim duarsh mes dy rivalëve, të cilët nuk ishin takuar më parë.

Politika e jashtme

Kandidatët, gjithashtu, shkëmbyen kritika për luftën në mes të Hamasit dhe Izraelit në Rripin e Gazës dhe agresionin rus në Ukrainë, megjithëse asnjëri nuk ofroi plane specifike për zgjidhjen e këtyre konflikteve.

Demokratja Harris akuzoi republikanin Trumpi se ishte i gatshëm ta tërhiqte mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Ukrainën për ta fituar favorin e presidentit rus Vladimir Putin, duke e quajtur Trumpin një "turp", ndërsa Trumpi pretendoi se Harris "urren" Izraelin, një pohim që ajo e hodhi poshtë. Trumpi kritikoi presidentin Biden dhe nënpresidenten Harris për tërheqjen e paorganizuar të trupave amerikane nga Afganistani, duke thënë se ata lanë duart e talebanëve pajisje ushtarake amerikane me vlerë prej miliarda dollarësh.

Sulmet personale

Trumpi, i cili ka kaluar javë të tëra duke bërë sulme personale ndaj Harrisit, duke përfshirë fyerje raciste dhe seksiste, kryesisht shmangu fyerjet në fillim të debatit, por u bë gjithnjë e më i zëmëruar nga kritikët e Harrisit. Trumpi u pyet nga moderatorët



për një nga ato sulme, kur ai tha në një konferencë me gazetarë afrikano-amerikanë në korrik se Harris "është një bërë një person me ngjyrë". "Nuk më intereson aspak kjo çështje", tha ai. "Çfarëdo që ajo dëshiron të jetë është në rregull me mua".

Harris, me origjinë zezake dhe aziatike, u përgjigj: "Unë mendoj se është një tragjedi që ne kemi dikë që dëshiron të jetë president, i cili vazhdimisht gjatë karrierës së tij është përpjekur të përdorë racën për ta përçarë popullin amerikan".

Ajo kritikoi Trumpin për shpalljen fajtor nga një juri për fshehjen e pagesave për një aktore e filmave pornografikë, si dhe paditë e tij të

tjera dhe një gjyq civil për sulm seksual. Trumpi hodhi poshtë këto akuza dhe sërish akuzoi Harrisin dhe demokratët se kanë orkestruar të gjitha paditë ndaj tij pa prova.

Ish-presidenti Trump gjithashtu përsëriti pretendimin e tij të rremë se zgjedhjet e vitit 2020, të cilat i fitoi demokrati Joe Biden, ishin manipuluar dhe e quajti Harrisin një "marksiste" dhe pohoi në mënyrë të rreme se migrantët kanë shkakuar një rritje të madhe të krimin të dhunshëm në vend.

Ky mund të jetë debati i vetëm mes tyre në fushatën për zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit. Debati mbahet tetë javë përpara ditës zyrtare të zgjedhjeve, por vetëm disa

ditë përpara fillimit të votimit të hershëm në disa nga 50 shtetet e vendit.

Debatet presidenciale nuk ndryshojnë domosdoshmërisht mendjet e votuesve, por ato mund të jenë shumë të rëndësishme. Paraqitja e dobët e Bidenit në debatin me Trumpin në qershor çoi në tërheqjen e tij nga gara për president më 21 korrik.

Debati, i organizuar nga kanali ABC, u mbajt në Qendrën Kombëtare të Kushtetutës në Filadelfia. Siç ishte rënë dakord nga drejtuesit e fushatave, nuk kishte audiencë të drejtpërdrejtë dhe mikrofonat e kandidatëve ishin të fikur në momentet kur kandidatët nuk e kishin radhën e tyre për të folur.

BE-ja ka frikë se Bregu Perëndimor do të shndërrohet në një "Gazë të re"

BRUKSEL, 11 SHTATOR - Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, paralajmëroi se rritja e dhunës në Bregun e pushtuar Perëndimor që kur ka shpërthyer lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja nënkupton se ky territor rrezikon të bëhet një "Gazë e re". Dhuna në Bregun Perëndimor, që Izraeli e ka pushtuar më 1967, është rritur që kur ka nisur lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit në Gazë më 7 tetor.

Borrelli tha se Izraeli po hap "një fron të ri... me një synim të qartë: ta shndërrojë Bregun Perëndimor në një Gazë të re, me rritjen e dhunës, delegjitimimin e Autoritetit Palestinez dhe me stimulimin e provokimeve për të reaguar me forcë". Izraeli, po ashtu, "po thotë para



botës se e vetmja mënyrë për të arritur deri te një zgjidhje paqësore është aneksimi i Bregut Perëndimor dhe Gazës", tha

Borrelli gjatë një takimi ministror të Ligës Arabe në Kajro. Ai akuzoi "anëtarët radikalë të qeverisë izraelite" se po tentojnë

"ta bëjnë të pamundur që në të ardhmen të krijohet një shtet palestinez", që kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe disa anëtarë të qeverisë së tij kanë thënë se paraqet kërcënim për Izraelin.

Disa ministra izraelitë së fundi kanë bërë thirrje për intensifikimin e operacioneve në Bregun Perëndimor. "Pa veprim, Bregu Perëndimor do të bëhet një Gazë e re", tha Borrelli. "Dhe Gaza do të bëhet një Breg i ri Perëndimor, pasi lëvizjet e kolonëve po përgatiten për vendbanime të reja", tha ai gjatë takimit.

Që kur ka nisur lufta në Gazë, trupat izraelite apo kolonët kanë vrarë të paktën 662 palestinezë në Bregun Perëndimor, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë. Në po të njëjtën periudhë kohore, të paktën 23

izraelitë, përfshirë anëtarë të forcave të sigurisë, janë vrarë gjatë sulmeve të palestinezëve në Bregun Perëndimor, sipas zyrtarëve izraelitë.

Izraeli ka pushtuar Bregun Perëndimor, së bashku me Gazën dhe Jerusalem Lindor gjatë Luftës së Lindjes së Mesme më 1967. Palestinezët duan që këto tri terriore të jenë pjesë e shtetit të tyre në të ardhmen. Tre milionë palestinezë në Bregun Perëndimor jetojnë në sundimin ushtarak izraelit, ndërkaq Autoriteti Palestinez, që mbështetet nga Perëndimi, ka kontroll të kufizuar në qendrat e populluara.

Më shumë se 500 000 kolonë hebre, që jetojnë në vendbanime të ndërtuara në mbarë territorin të cilat konsiderohen nga shumica e komunitetit ndërkombëtar si të paligjshme, kanë shtetësi izraelite.

Qeveria miraton ndryshimet në Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Qeveria e Kosovës i ka miratuar të mërkurën disa ndryshime në Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, pasi Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur atë të pavlefshëm. Kushtetuesja tha më 26 qershor në një aktgjykim se kishte gjetur se katër nene të ligjit ishin në kundërshtim me Kushtetutën e vendit.

Në mbledhjen e qeverisë mbajtur të mërkurën, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se ministria e saj i ka adresuar gjetjet dhe i ka bërë ndryshimet e nevojshme në këto katër nene pas vendimit të Kushtetutës.

Ndryshimet e propozuar nga ajo u miratuan nga kabineti qeveritar. Këto ndryshime duhet të miratohen edhe nga Kuvendi. "Ne nuk kemi hartuar ligj të ri, sepse nuk ka pasur nevojë për këtë, por i kemi adresuar vetëm katër çështje që janë konsideruar kundër Kushtetutës", tha ajo. Haxhiu tha se çështja e parë që është adresuar është retroaktiviteti i ligjit.

Kushtetuesja gjeti se shtrirja e gjatë kohore mund të krijojë sfida për palët e përfshira, duke i vendosur ato në një pozicion "të pamundësisë objektive për të siguruar prova që justifikojnë prejardhjen e pasurisë së tyre". Ndryshimi i ri në këtë çështje, sipas saj, përfshin "konceptin e pamundësisë objektive, si një element kyç procedural", i cili

ofron një mekanizëm mbrojtës për ata të cilët nuk mund të ofrojnë prova për shkak të kalimit të kohës apo faktorëve të tjerë objektivë. "Kjo qasje e re ndihmon në garantimin e një procesi më të drejtë dhe më të qartë për të gjitha palët e përfshira në procedurat e konfiskimit", tha ajo.

Ndryshimi i dytë ka të bëjë me qartësimin e periudhës kohore për verifikimin e pasurisë. "Ndryshimet e reja sigurojnë që periudha e verifikimit të pasurisë të lidhet me periudhën kur zyrtari publik ka qenë në funksion duke lejuar përjashtimisht zgjatjen e verifikimit për pesë vjet pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, nëse vlerësohet se pasuria është dukshëm më e lartë sesa të ardhurat e ligjshme", tregoi Haxhiu.

Neni i tretë që u shpall i pavlefshëm, komisioni mbikëqyresh dhe ndarja e pushteteve, është ndryshuar, po ashtu.

Haxhiu tha se komisioni është ndryshuar dhe tani përbëhet nga tre anëtarë që do të zgjidhen nga Kuvendi, përfshirë drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Drejtorin e Njësisë së Inteligjencës Artificiale. Në ligjin e shpallur të pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese, parashihej që të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë mund të ishin subjekt i verifikimit të pasurisë nëse do të ekzistonin dyshime se ajo ishte fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Përveç zyrtarëve, subjekt i verifikimit dhe konfiskimit të

Qeveria aprovon një Program Kombëtar për Mbrojtje Gjithëpërfshirëse

Qeveria e Kosovës e ka miratuar të mërkurën një Program Kombëtar për Mbrojtje Gjithëpërfshirëse, i cili synon mbrojtjen e vendit nga kërcënimet, sulmet dhe fatkeqësitë natyrore.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se programi ua mundëson institucioneve qendrore dhe lokale, veçanërisht qytetarëve, si dhe organizatave të ndryshme joqeveritare, ta kenë rolin e tyre në mbrojtjen e jetës, sigurisë dhe pasurisë. "Ministria e Mbrojtjes ka hartuar Programin Kombëtar për Mbrojtjen Gjithëpërfshirëse të Kosovës. Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme konvencionale dhe jokonvencionale dhe ruajtja e

jetës dhe pasurisë së qytetarëve në raste të fatkeqësisë natyrore janë interesa jetike të Republikës së Kosovës", tha Kurti.

Kurti tha se programi është hartuar bazuar në sistemet e ngjashme të vendeve anëtare të NATO-s, aleancës ushtarake që Kosova synon t'i bashkohet.

Programi, sipas tij, synon të ndërtojë "qëndrueshmëri kombëtare" në Kosovë, në mënyrë që shoqëria e Kosovës të përgatitet "të rezistojë, të reagojë e të rimëkëmbët në raste të fatkeqësive natyrore, apo sulmeve të armatosura". "Sistemi ka në thelb mbështetjen që qytetarët ia japin në baza vullnetare ushtrisë sonë, FSK-së, por edhe të kombinuar me strukturat e tjera shtetërore", shtoi ai.

Ndërkohë, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, tha se ministria e tij e ka hartuar programin mbi bazën e objektivave dhe planifikimeve strategjike. Ai tha se programi bazohet në shtatë shtylla: funksionimin shtetëror në rast krizash, organizimin shtetëror

për mbrojtjen e vendit, mirëmbajtjen e funksioneve vitale, shërbimeve thelbësore të shtetit, qëndrueshmërinë shoqërore, qëndrueshmërinë e furnizimeve shtetërore, mbrojtjen e hapësirës së informacionit dhe edukimin e të rejave dhe të rinjve.

Programi, tha ai, nuk ndërhyt në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) bazuar në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, por u mundëson qytetarëve të luajnë rol vullnetar në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.

Procesi i transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës ka nisur në dhjetor të vitit 2018, kur Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore për ta ndryshuar mandatin e FSK-së. Ky proces është planifikuar të zgjasë dhjetë vjet - deri në vitin 2028.

Forca e Sigurisë së Kosovës aktualisht ka rreth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së tranzicionit, ky numër pritet të rritet në më shumë se 7 500 dhe do të përfshijë anëtarë aktivë dhe rezervë.

pasurisë së pajustificueshme parashihej të ishin edhe anëtarët e familjes së tyre apo palët e treta, që nënkupton personat te të cilët mund të ketë pasur dyshime se ishte bartur pasuria e zyrtarëve publikë.

Kushtetuesja tha se procedura e verifikimit dhe konfiskimit të

pasurisë së pajustificueshme është e pavarur nga procedura penale, "standardi i të provuarit nuk është ai penal i 'dyshimit të bazuar', por ai civil i 'vlerësimit të gjasave' dhe, sipas të cilit, pasuria cilësohet e pajustificueshme, nëse gjykata, bazuar në prova, 'beson që një gjë ka më shumë

mundësi të jetë apo të ketë ndodhur sesa jo".

Ligji, që është shpallur i pavlefshëm, përfshinte periudhën nga data 17 shkurt 2008, dhe periudhën brenda dhjetë vjetësh nga momenti kur zyrtarët publikë pushojnë së ushtruar funksionin e tyre.



Ngrihet aktakuzë ndaj 45 personave për sulmin në Banjskë, në mesin e tyre edhe Radoiçiqi

Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave në rastin e sulmit terrorist që ndodhi vitin e kaluar në Banjskë. Në mesin e personave që është ngritur aktakuzë është edhe Milan Radoiçiqi. Të përfshirët, sipas prokurorit të rastit, Naim Abazi, kanë pasur role të ndryshme brenda grupit të tyre kriminal, “duke filluar nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri te financimi dhe shpëlarja e parave”. “Në mesin e të akuzuarve kryesorë është edhe individi me pozitë kyçe si udhëheqës i grupit, Millan Radoiçiq, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në koordinimin dhe veprimtarinë kriminale”, tha Abazi.

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi të mërkurën se ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoiçiq - për sulmin e armatosur në Banjskë. Të përfshirët, sipas prokurorit të rastit, Naim Abazi, kanë pasur role të ndryshme brenda grupit të tyre kriminal, “duke filluar nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri te financimi dhe shpëlarja e parave”. “Në mesin e të akuzuarve kryesorë është edhe individi me pozitë kyçe si udhëheqës i grupit, Millan Radoiçiq, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në koordinimin dhe veprimtarinë kriminale”, tha Abazi në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën në Prishtinë.

Në Banjskë të Zveçanit, pjesa veriore e Kosovës, një grup i armatosur serbësh sulmoi Policinë e Kosovës më 24 shtator të vitit të kaluar, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Në përlëshjet e armatosura që pasuan, u vranë tre sulmues serbë. Prokurori Abazi nuk e përmendi përfshirjen e mundshme të shtetit të Serbisë në sulm - gjë që, më herët, është potencuar vazhdimisht nga autoritetet e Kosovës, edhe pse ajo vetë e ka mohuar. Pesë ditë pas ngjarjes, më 29 shtator, përgjegjësia për sulmin e mori Radoiçiq, ish-politikan dhe biznesmen nga veriu i Kosovës, i cili besohet se gjendet në Serbi. Prokuroria e Lartë Publike në

Beograd është duke kryer, po ashtu, hetime për rastin. Ajo e ngarkon Radoiçiqin me disa vepra penale që kanë të bëjnë me blerje të paligjshme të armëve dhe “shkaktim të rrezikut të përgjithshëm”. Prokurori Abazi tha se falë bashkëpunimit ndërkombëtar me ShBA-në, me shtete të BE-së dhe të tjera, prokuroria ka arritur të sigurojë “prova që ndihmuan në ngritjen e kësaj aktakuze të fuqishme”. Ai tha se gjatë procesit të hetimeve “janë sekuestruar dhe konfiskuar prona, automjete të blinduara, para të gatshme dhe llogari bankare, të cilat dyshohet se janë fituar nga aktivitete të paligjshme”. Sipas tij, janë konfiskuar “mbi 1 266 armë dhe pajisje të tjera”. “Ky veprim ka për qëllim ta parandalojë përdorimin e këtyre aseteve për aktivitete të mëtejshme kriminale, duke goditur strukturën financiare të këtij grupi kriminal”, tha Abazi. Sa i përket veprës penale të pastrimit të parave, shtoi ai, hetuesit kanë zbuluar se “fondet janë transferuar nëpërmjet rrjeteve të ndërlikuara financiare, duke përfshirë biznese të regjistruara në emra të personave të tretë dhe investime në pasuri të paluajtshme”. “Nga kjo aktakuzë, presim që të gjithë të përfshirët në këtë rast të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre”, tha Abazi. Në fund të vitit të kaluar, me kërkesë të Ministrisë së Brendshme të Kosovës,

organizata ndërkombëtare e policisë, Interpol, lëshoi fletarrestim për Radoiçiqin. Ai besohet se është i lirë në Serbi, ndërsa në Kosovë janë ndaluar tre persona në lidhje me rastin. Muajin e kaluar Ministria e Drejtësisë e Kosovës refuzoi kërkesën e Prokurorisë së Lartë Publike në Beograd për informacione në lidhje me këtë rast. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha pas sulmit se Radoiçiqi gjendet në “territorin e Serbisë qendrore”. Që atëherë nuk ka pasur ndonjë informacion zyrtar për vendndodhjen e tij. Prokuroria e Lartë Publike në Beograd tha në tetor të vitit të kaluar se Radoiçiq akuzohet për sigurimin e armëve, municioneve dhe mjeteve shpërthyes me fuqi të madhe shkatërruese nga Tuzla - qytet në verilindje të Bosnjë-Hercegovinës - në periudhën nga janari deri më 24 shtator të vitit të kaluar. Ai u akuzua edhe për “shkaktim të rrezikut të përgjithshëm”. Gjykata e Lartë në Beograd, tetorin e kaluar, e refuzoi kërkesën e Prokurorisë për ndalimin e tij dhe e la të lirë, por ia konfiskoi pasaportën dhe ia ndaloi shkuarjen në Kosovë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka kushtëzuar vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë me dorëzimin e Radoiçiqit dhe të “grupit të tij paramilitar terrorist” tek autoritetet gjyqësore të

Kosovës. “Për aq kohë sa Radoiçiqi dhe grupi i tij janë të lirë dhe të mbrojtur në Serbi, nuk ka mirëbesim në dialogun për normalizim”, tha Kurti më 28 qershor. Udhëheqja shtetërore në Serbi ka mohuar disa herë se ka gisht në sulmin në Banjskë. Në muajin mars disa medie kanë raportuar se ambasadori i atëhershëm i Serbisë në ShBA, Marko Gjuriq, është takuar me Radoiçiqin, por REL-i nuk ka arritur ta përcaktonte vërtetësinë e fotografisë që qarkullonte atëkohë. Komuniteti ndërkombëtar disa herë ka bërë thirrje për llogaridhënie dhe ka kërkuar që ata që janë të përfshirë në sulmin në Banjskë, të sillen para drejtësisë. (Rel)

Kush është Radoiçiqi?

Millan Radoiçiqi ishte nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Ai dha dorëheqje nga kjo pozitë pak ditë pas sulmit në Banjskë. Prej vitesh ai është i sanksionuar nga ShBA-ja dhe Britania e Madhe për pjesëmarrje në krim të organizuar ndërkombëtar. Departamenti Amerikan i Shtetit e cilëson atë kriminel që duhet të mbahet përgjegjës.

Ish-ministri Hasani: Falë atyre djemve çlirimtarë që janë në Hagë, Kurti gëzon pozitën e kryeministrit



Ish-ministri i Tregtisë, Bajram Hasani, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i mbështesë financiarisht udhëheqësit e UÇK-së në procesin me të cilin po përballen në Hagë. Ai ka theksuar se procesi i Hagës është proces i shtetit të Kosovës. "Sot ka ardhur koha që këta pushtetarë ua ndalin edhe financat. Është vërtet për të ardhur keq", ka thënë Hasani, duke shtuar se falë atyre djemve çlirimtarë që janë në Hagë, Kurti gëzon pozitën e kryeministrit

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ish-ministri i Tregtisë, Bajram Hasani, ka qenë i ftuar në emisionin 'Zona Zero' në Top News me Milaim Zekën. Ai në këtë intervistë ka folur për zhvillimet politike dhe ekonomike në vend, por edhe për çlirimtarët që po mbahen në

paraburgim në Hagë. Ai ka thënë se gëzon respektin më të madh për krerët e UÇK-së pasi, sipas tij, ata janë liria e Kosovës. "Sot ka ardhur koha që këta pushtetarë ua ndalin edhe financat. Mendoj se procesi i Hagës është proces i shtetit të Kosovës. Atje po gjykohe

krerët e UÇK-së, e ne themi nuk po gjykohe UÇK-ja. Atje janë komplet krerët e UÇK-së dhe është vërtet për të ardhur keq. Nuk mbështeten njerëzit që ta kanë sjell lirinë. Sot e gëzon edhe pozitën e kryeministrit falë atyre djemve që sot gjenden në Hagë", ka thënë ish-ministri Hasani.

Duke folur për zhvillimet e fundit në vend, Hasani ka theksuar se nuk është i kënaqur me zhvillimet në Kosovë. "Po na shqetëson fakti se është një moskoordinim me aleatët tanë me të cilët së bashku e kemi fituar luftën dhe e kemi shpallur pavarësinë, e sot duke e ndërtuar shtetin nuk po koordinohemi, e ky për mua është shqetësim i madh", ka deklaruar Hasani.

Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë ka thënë se

presidentja Vjosa Osmani nuk e ka luajtur rolin e saj si presidente e shtetit sa i përket zhvillimeve në vend. "Ajo vetëm sa e ka vulosur atë çfarë ka thënë Albin Kurti. Ajo duhet ta luajë rolin që i takon me Kushtetutë dhe të mos mbajë anë politike", ka deklaruar Hasani.

Duke folur për qeverinë Kurti në aspektin ekonomik gjatë këtij mandati, ish-ministri Hasani ka thënë se ka pasur keqqeverisje edhe në aspektin ekonomik, duke mos pasur një strategji të mirëfilltë në këtë aspekt. Ai ka thënë se Kurti me veprimet në veri është duke i mbuluar dështimet ekonomike. Hasani është pyetur edhe për kandidaturën e Bedri Hamzës për kryeministër. "Kam punuar me të dhe kemi qenë në qeveri së bashku. Ai është një

ekonomist i mirë. Ka logjikë të zhvillimit ekonomik. Mendoj se Kurti sot i ka dy kandidatë seriozë, duke mos përjashtuar edhe kryetarin e LDK-së", ka thënë ai.

Hasani ka thënë se Bedri Hamza është personi i denjë për ta udhëhequr një qeveri me perspektivë të zhvillimit ekonomik. Ai ka shtuar se tashmë vendi po shkon drejt zgjedhjeve të reja parlamentare, duke theksuar se sot opozita duhet ta ballafaqojë Albin Kurtin me Albin Kurtin për ato çfarë u ka premtuar qytetarëve dhe nuk i ka realizuar.

Ish-ministri Hasani nuk ka qenë i kënaqur me punën që ka bërë opozita gjatë këtij mandati të qeverisë Kurti. Ai ka thënë se opozitë më të madhe kanë bërë mediet.

Ngritja e aktakuzës për Banjskën, Konjufca: Më mirë vonë se kurrë

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka komentuar ngritjen e aktakuzës ndaj 45 personave, në mesin e të cilëve Milan Radoiçiç, lidhur me sulmin terrorist në Banjskë.

Ai ka thënë se "më mirë vonë se kurrë", duke e konsideruar si lajm të mirë ngritjen e aktakuzës. "Ky po që është një lajm i mirë dhe një lajm për të cilin nuk dua t'i jap kritikën se përse u vonua kaq shumë. Frazja më e mirë që i shkon këtij lajmi është 'më mirë vonë se kurrë' dhe kështu ka ndodhur. Me

siguri Prokurorisë i është nevojitur gjithë kjo kohë për ta kompletuar dosjen e aktakuzës sa i përket atij numri të madh të kriminelëve që ishin të përfshirë në këtë sulm", ka thënë Konjufca.

Kryeparlamentari ka thënë se ky proces duhet të shkojë ashtu siç duhet. "Pasi kjo çështje të bëhet objekt i drejtësisë, ne gjithë fokusin ta kemi në institucionet e drejtësisë. Duhet që kriminelët që ishin përgjegjës ku u vra rreshteri Afrim të dalin para bankave të drejtësisë", ka thënë ai.



Rritet numri i rasteve për trajtim mjekësor pas kafshimit nga qentë endacakë

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Bazuar në statistikën e Klinikës Emergjente, është rritur numri i rasteve që kanë kërkuar trajtim mjekësor si pasojë e dëmtimeve trupore nga kafshimi i qenve endacakë.

Nga 1 janari deri më tani janë regjistruar 112 raste që kanë pësuar dëmtime të ndryshme trupore, përfshirë edhe raste

me lëndime më të rënda që rrezikojnë jetën, e që janë spitalizuar për trajtim të mëtutjeshëm në Klinikën Infektive.

Vitin e kaluar në Klinikën Emergjente ishin regjistruar 84 raste që kishin kërkuar tretman mjekësor nga kafshimi i qenve, kurse këtë vit ka rritje të rasteve të tilla.

“Vazhdojmë të apelojmë tek

Komuna e Prishtinës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të bëjnë zgjidhje të shpejtë për këtë çështje. QKUK është institucion që kujdeset dhe ofron shërbime shëndetësore, andaj mos të shndërrohet në institucion ku rrezikohet jeta e pacientëve, familjarëve dhe qytetarëve tjerë, si pasojë e kafshimit nga qentë”, ka njoftuar QKUK-ja.



Spiropali shpreh gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë në fushën e parlamentarizmit

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim të mërkurën kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Elisa Spiropali.

Konjufca e ka uruar për detyrën e re, me bindje të plotë se jo vetëm që do ta vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë e shembullor që kanë pasur mes institucioneve legjislative, por ta forcojnë atë edhe më tej. “Shtetet tona kanë lidhje të natyrshme vëllazërore, sepse janë themeluar mbi sakrificat dhe përpjekjet e të njëjtit komb. Kjo na obligon të qëndrojmë gjithnjë afër, duke mbajtur natyrshëm të palëkundur parimin e mospërrashtimit mes interesit të shteteve tona dhe atij kombëtar. Në këtë kuptim,

znj. Spiropali e falënderova për vizitën e saj të parë në Kosovë në cilësinë e kryekuvendares, sepse ky takim i shërben vizionit të përbashkët të raporteve përplotësuese që na shtojnë të ecim përpara së bashku”, ka thënë Konjufca.

Ai ka bërë me dije se i ka kërkuar Spiropalit mbështetjen dhe angazhimin e saj si dhe të institucionit që drejton, për ta vazhduar punën e përbashkët në fushën e parlamentarizmit dhe sidomos në arenën ndërkombëtare, sepse mbështetja e ardhur nga Republika e Shqipërisë është e pazëvendësueshme dhe me domethënie të paçmueshme për Republikën e Kosovës si dhe për lehtësimin e proceseve nëpër të cilat ecën shteti ynë.



Ndërkaq kryetarja Spiropali ka shprehur gatishmërinë e saj pa rezerva, për të punuar me të gjitha kapacitetet në drejtim të ruajtjes dhe thellimit të bashkëpunimit mes dy parlamenteve, duke falënderuar për pritjen e duke pasur shumë pritshmëri e optimizëm për punën që na pret.

Edhe në konferencën e përbashkët për medie, Konjufca dhe Spiropali rivendosën në dukje domosdoshmërinë e mbështetjes së ndërsjellë, si dhe bindjen e përbashkët se sfida e Kosovës në raportet me Serbinë vendoset në rrugë të drejtë sa kohë bazohet në njohje të ndërsjellë, shkëputje e ndëshkim ndaj së shkuarës së krimeve të luftës.

Kurti bën homazhe në përkujtim të viktimave të 11 shtatorit 2001



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla dhe zëvendësshefen e Misionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Anu Pratipati, bënë të mërkurën homazhe dhe vendosën lule të freskëta pranë pllakës përkujtimore “Kosova Kujton”, në oborrin e ndërtesës së qeverisë, për t'i përkujtuar dhe nderuar viktimat e sulmit terrorist të 11 Shtatorit, që ndodhën në vitin 2001 në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës.

Në përkujtim të viktimave të atij sulmi mizor e terrorist kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryeministri Kurti u shpreh se sot kujtimi ynë shkon për viktimat, si dhe solidariteti ynë me familjet që i kanë humbur më të dashurit e tyre. Kryeministri më tej kujtoi se në mesin e atyre që u vranë para 23 vjetësh ishin edhe tre bashkatdhetarë shqiptarë të familjeve Camaj, Dedvukaj dhe Gjonbalaj.

Ai shtoi se terrorizmi duhet luftuar nga të gjithë dhe duhet

bashkëpunimi i secilit shtet, secilës qeveri, secilit aktor dhe faktor, secilit politikan, secilit qytetar lirisdashës, i cili dëshiron paqe, demokraci, të drejta të njeriut, pluralizëm politik dhe mirëqenie, që nuk diskriminon asnjëri. “Republika e Kosovës qëndron pranë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë ditë përkujtimi dhe theksojmë partneritetin, aleancën dhe miqësinë tonë të fuqishme në çdo aspekt e në veçanti në luftë kundër terrorizmit”, përfundoi kryeministri.

UP-ja hap konkurs për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Universiteti i Prishtinës ka hapur konkurs për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2024/2025. “Me kënaqësi ju njoftojmë se Universiteti i Prishtinës ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për

vitin akademik 2024/2025. Universiteti i Prishtinës ofron programe të fushave të ndryshme studimi, të krijuara për të adresuar nevojat dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe për të promovuar zhvillimin akademik, profesional dhe personal të studentëve”, ka njoftuar UP-ja.

UP-ja ka theksuar se

përkushtohet për të ofruar një mjedis akademik të pasur me mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe personal. “Ju ftojme të bëheni pjesë e një institucioni me traditë dhe cilësi të lartë arsimore. Aplikimet janë të hapura deri më 24 shtator 2024 në orën 14:00”, ka njoftuar UP-ja.



Hoxhaj kujton ditën kur me Thaçin përmbyllën pavarësinë: Sot Kosova është në sanksione perëndimore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka kujtuar një datë të rëndësishme për Kosovën, atë të fundit të mbikëqyrjes së pavarësisë, që ndodhi më 10 shtator të vitit 2012. Në një postim në "Facebook", Hoxhaj ka publikuar një fotografi të përbashkët me Hashim Thaçin, atëbotë kryeministër.

Hoxhaj ka thënë se është shumë krenar që ka qenë pjesë e negociatave të procesit të Ahtisaarit në vitet 2006-2007, gjithashtu i përbushjes së kritereve dhe obligimeve ndërkombëtare në mes të viteve 2008-2012. "Më 10 shtator 2012, Kosova hapi një kapitull të ri të shtetësisë së saj. Grupit Drejtues Ndërkombëtar vendosi për ta përfunduar mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës, pasi ajo nga viti 2008 e deri në shtatorin e 2012, kishte përbushur të gjitha



obligimet e marra nga Pakoja e Ahtisaarit. Kjo datë shënon gjithashtu një fazë të re, sepse shteti ynë i ri u tregua këmbëngulës që të bëjë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për t'i marrë përsipër përgjegjësitë, të cilat që nga shpallja e pavarësisë e këndej i kishe ushtruar Zyra Civile Ndërkombëtare, e cila me këtë vendim edhe e përfundoi mandatin dhe mbylli misionin e

saj në Kosovë! Jam shumë krenar që kam qenë pjesë e negociatave të procesit të Ahtisaarit në vitet 2006-2007, por gjithashtu i përbushjes së kritereve dhe obligimeve ndërkombëtare në mes të viteve 2008-2012", ka shkruar Hoxhaj. Ai ka thënë se kjo datë jo vetëm që ia ktheu popullit të Kosovës atë që i takon, qeverisje të plotë demokratike dhe një sovranitet të mirëfilltë, por hapi edhe një

horizont të ri për vendin. "Filloi të ushtrohej një politikë e jashtme më e pavarur, forcoi pozitën e Kosovës në arenën ndërkombëtare me njohje të reja dhe anëtarësi të shumta në organizata ndërkombëtare, por edhe ndërtoi një partneritet të barabartë me bashkësinë ndërkombëtare. Jam shumë krenar që si ministër i jashtëm kam koordinuar, me mandat të kryeministrit Thaçi, procesin e

përmbylljes së pavarësisë, duke vendosur themelet e politikës së jashtme!", ka shkruar ish-ministri i jashtëm.

Hoxhaj ka shtruar edhe një pyetje se pas kaq shumë vitesh: "Ku jemi sot? "Shtatori i 2012 ishte ngjarje e pjekurisë sonë politike, por shtatori i 2024 është dëshmi e papjekurisë sonë politike. Në vend se të ndërtohet edhe më shumë identiteti kushtetues dhe shtetëror, Kosova është nën sanksione perëndimore dhe Kushtetuta shkelet çdo ditë. Në vend që të ndërtohen marrëdhënie edhe shumë më të mira me shtetet e rajonit, me aleatet e saj në Evropë, Amerikë dhe botë, Kosova ka mbetur pa aleatë, pa kredibilitet dhe mjerisht, nuk merret seriozisht! Në shtator të vitit 2012 ishte shembull i zbatimit të obligimeve të marra nga partnerët e Kosovës, sot është shembull që gënjen dhe mashtron aleatët më strategjikë, ku qeverisja e saj mjerisht shihet njëjtë në Perëndim dhe në Lindje si grandaveç, sherraxhi dhe zhurmmaxhi!", ka shkruar Hoxhaj.

Rama takon drejtorin e policisë për rajonin e Prishtinës, diskutojnë për situatën e sigurisë në kryeqytet

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim drejtorin e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Basri Shabani, për të diskutuar rreth situatës së përgjithshme të sigurisë në kryeqytet. "Pas një numri të incidenteve të kohëve të fundit në kryeqytet, shqyrtuam masat potenciale për adresim të situatës. U dakorduam të risim bashkëpunimin me Prokurorinë e Shtetit dhe gjykatat kompetente për reagimin më të shpejtë për këto raste, marrjen e



masave parandaluese si dhe fuqizimin e politikave ndëshkuese ndaj shkaktesve të veprave penale në kryeqytet", ka

shkruar Rama në "Facebook". Më tutje, ai i ka përcjellë drejtorit Shabani rëndësinë e lëvizjes së lirë të këmbësorëve

dhe ka kërkuar fokus më të madh të policisë për lirim të trotuarëve nga veturat e parkuara ilegalisht dhe parkingjet ilegale në përgjithësi. "U dakorduam që në mënyrë urgjente të gjejmë zgjidhje për të angazhuar kompani për largimin e veturave të parkuara ilegalisht. Shkëmbyem informata edhe rreth zbatimit të projektit digitalizues të Qytetit të Mençur (Smart City) dhe lidhshmërinë e këtij projekti me punët operative të Policisë. Drejtori Shabani kërkoi nga institucionet e Kryeqytetit që të rritet numri i inspektorëve komunal mbas orës 22:00 në

mënyrë që të rritet efikasiteti i reagimit të institucioneve të sigurisë dhe të kryeqytetit", ka bërë me dije Rama.

Po ashtu, drejtori Shabani e informoi kryetarin Rama se, pavarësisht prej disa incidenteve të sigurisë, ka trendë pozitivë në rënien e numrit të veprave penale, aksidenteve të trafikut, në veçanti atyre me fatalitet, si dhe rritje të numrit të rasteve të zbuluara. "Kryeqyteti do të vazhdojë të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës drejt ofrimit të një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët", ka shkruar Rama në "Facebook".

Protestë në Mitrovicën e Veriut për shkak të arrestimeve

MITROVICË E VERIUT, 11 SHTATOR - Më 11 shtator, qindra pjesëtarë të komunitetit serb janë duke protestuar para stacionit të policisë në Mitrovicën e Veriut në shenjë pakënaqësie ndaj arrestimit të katër të rinjve serbë një ditë më parë nga Policia e Kosovës. Disa aktivistë serbë dhe qytetarë të Mitrovicës së Veriut kanë thënë se të rinjtë janë rrahur nga zyrtarët policorë, ndërsa Policia e Kosovës ka deklaruar se të rinjtë në fakt kanë sulmuar dy policë dhe se

gjatë arrestimit është përdorur forcë minimale për t'ua vënë prangat. Protestuesit po mbajnë pankarta me mbishkrimin "Lironi fëmijët tanë" dhe "Policia e Kurtlandit", si dhe po përdorin bilbila për ta shprehur pakënaqësinë e tyre. Në protestë ishte i pranishëm edhe anëtari i partisë Demokracia Serbe, i cili pretendon se Policia e Kosovës po përdor forcë të tepruar. Më parë, për arrestimin e të rinjve reagoi edhe Lista Serbe,

partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetur e Beogradit, duke theksuar se "brutaliteti i Policisë së Kosovës ndaj serbëve, në drejtimin e kryeministrit Albin Kurti, është bërë përditshmëri në veri të Kosovës". Reagime ka pasur edhe nga Beogradi, duke pretenduar se Policia e Kosovës i ka rrahur të rinjtë, ndërsa nga Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë kanë deklaruar se ekziston një video e ruajtur që provon



"torturën". Katër të rinjve të ndaluar në Mitrovicë të Veriut, për "sulm

ndaj personit zyrtar", të martën u është caktuar masa e paraburgimit.

Fillojnë punën në KEK 149 punëtorë të rinj

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryeministri Kosovës, Albin Kurti dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kanë vizituar Termocentralin "Kosova B" të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), në të cilin janë duke u bërë remonte në përgatitje për sezonin e dimrit.

Vizita e kryeministrit Kurti dhe ministres Rizvanolli kishte qëllim për t'i parë nga afër kushtet dhe punët që po zhvillohen në remontin e Bllokut B2, bashkëbisedim me punëtorët e KEK-ut në lidhje me angazhimin e tyre

dhe sfidat me të cilat përballen ata.

Po ashtu, në KEK kanë filluar punën 149 punëtorë të rinj, për të cilin kryeministri nënvizoi rëndësinë e shtimit të kuadrove të reja dhe inkuadrimit të sa më shumë të rinjve e të rejave. "Ne e duam dhe e vlerësojmë lart KEK-un si burim natyror i energjisë, si kapacitet prodhues e zhvillimor, njëkohësisht edhe si organizatë e punëtorëve që po zgjerohet sot", ka theksuar kryeministri Kurti.

Ndërsa ministrja Rizvanolli pohoi se së bashku me

kryeministrit Albin Kurti vizituan punimet për remontin në KEK, të cilat janë kyçe për të siguruar më shumë energji dhe stabilitet energjetik për vendin dhe ky proces i domosdoshëm na afron një të ardhme më të sigurt energjetike.

Ajo ka shtuar se në përfundim të kësaj vizite tejet të nevojshme, takuan edhe 149 punonjësit e rinj të Elektroenergjetikës, përfshirë 10 vajza e gra që sot u bënë pjesë e Korporatës Energjetike të Kosovës dhe, siç tha ajo, kjo përbën investim të



rëndësishëm në për të ardhmen e KEK-ut, duke sjellë kapacitete të reja dhe energji të

frëskët në korporatë e çdoherë duke ndikuar që sa më shumë të rritet numri i vajzave e grave.

Haradinaj: I çuditshëm dhe krejt i pakuptimtë lavdërimi i Kurtit për KEK-un dhe sukseset e tij



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj e ka quajtur të çuditshëm dhe të pakuptimtë lavdërimin që kryeministri Albin Kurti thotë se ia ka bërë Korporatës Energjetike të Kosovës.

Haradinaj në "Facebook" ka shkruar se "sikur të mos ishte tragjike, do të ishte komike, pasi ai qartë shihet se e ka gabuar audiencën". "I çuditshëm dhe krejt i pakuptimtë lavdërimi i Kurtit për KEK-un dhe sukseset e tij. Sikur të mos ishte tragjike, do të ishte komike, pasi ai qartë shihet se e ka gabuar audiencën. Kur e lexon

postimin e tij, të jep përshtypjen sikur ai u është drejtuar jo KEK-ut dhe punëtorëve të tij, por atyre që janë përfitues të mëdhenj të KEK-ut: pra, atyre që i ndjek ligji për afëra në KEK dhe blerje të energjisë, atyre që marrin rrogë me kontrata të fshehta nga EPS, por edhe të gjithë dilerëve të energjisë në rajon. Jo KEK-ut, jo, se me asgjë s'ia kanë parë hajrin Albin Kurtit, bile as me bojlerë as me spoilerë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se përveç 21 milionë euro dëmshpërblim që ka paguar, po të ishte burrë Albin Kurti, do të tregonte sa qindra miliona euro ka importuar që nga koha kur

është kryeministër, me çfarë çmimi dhe nga kush. "Kurti, këtë ua ke borxh njerëzve të këtij vendi. Është e sigurt se ai nuk do të tregojë për shumat, e edhe shitësit e rrymës do të përpiqet t'i fshehtë, por ai duhet të dijë që pushtetet nuk janë të përjetshme. Refuzimi i gazit amerikan dhe anulimi i projektit Kosova C, shtrenjtimi i dyfishit të energjisë për qytetarin, aty do të jenë. Kosovës i mbetet që edhe këtë dimër të lutet që do të jetë dimër i butë dhe të ketë rrymë të mjaftueshme dhe çmim të lirë në treg. Ndryshe, keq do të jetë për gjithë vendin", ka thënë Haradinaj.

51 biznese nga Kosova do të marrin pjesë në panairin e gastronomisë shqiptare 'Global Albanian Gastronomy Festival'

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka mbajtur takim parapërgatitor me bizneset që do të marrin pjesë në panairin e gastronomisë shqiptare "Global Albanian Gastronomy Festival", i cili do të mbahet në Berlin të Gjermanisë nga data 2 deri më 3 tetor 2024.

Gjatë takimit u diskutua lidhur hapësirën ekspozuese që ka



Kosova në këtë panair në të cilin do të prezantohen 51 biznese nga Kosova.

Ndër të tjera, u fol rreth procedurave përgatitore të bizneseve për produktet që do të ekspozohen si dhe për procedurat e tjera për paraqitje sa më të mirë të bizneseve në këtë panair.

MINT/KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese në një sipërfaqe prej 500m2 për pjesëmarrjen e 51 bizneseve vendore, ndërsa ndërtimi i shtandit standard për këto biznese

do të mbulohet nga projekti i USAID-it "Compete Activity".

Ky aktivitet organizohet nga KIESA dhe projekti i USAID-it "Compete Activity", në bashkëpunim me shoqatat prodhuese të sektorëve specifikë, me qëllim të promovimit të kompanive nga Kosova të sektorit të ushqimit, pijeve, produkteve joushqimore, drurit dhe TIK-ut, si dhe të përkrahjes së tyre për gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve.

Bekim Hoxha emërohet drejtor i AUV-it

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Qeveria e Kosovës me shumicë votash ka miratuar propozim-vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, për emërimin e Bekim Hoxhës në krye të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, para kabinetit qeveritar paraqiti për miratim këtë propozim-vendim. "Miratimi i këtij propozim-vendimi

përbën një hap të rëndësishëm lidhur me menaxhimin - drejtimin e AUV-it si agjenci kyçe në implementimin e politikave zhvillimore të bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore në vend. Komisioni rekrutes ka qenë i përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe ekspert të jashtëm të cilët kanë shqyrtuar aplikimet për këtë pozitë dhe kanë

vlerësuar si të duhur Bekim Hoxhën", tha Peci.

Ai shtoi se Hoxha ka përgatitje në nivelin akademik dhe institucional. "Ka përfunduar studimet në Universitetin e Zagrebit dhe pjesë të specializimeve në master për zhvillim rural dhe supspecializim në aspektin agromjedisor në Universitetin e Kentit në Mbretëri të Bashkuara", tha Peci.



'Clinti më ngjante me një mace': Sergio Leone për rolin që e bëri Eastwoodin një yll filmi



Nga: Francis
AGUSTIN / BBC

Një burrë veshur me një ponço të pluhurosur dhe me një kapelë në kokë, lëviz në një rrugë të zbrazët në një qytet të shkretuar. "Bëjë gati tri arkivole", udhëzon ai një zdrukthëtar përpara se të përballet me burrat që e kishin tallur. "Gabimi im", shtoi ai pasi vrau banditët. "Katër arkivole". Ky është një nga momentet që përcaktoi pushkatarin e rreptë të luajtur nga Clint Eastwood në Një grusht me dollarë [A Fistful of Dollars, 1964], film që ndryshoi rrjedhën e kinemasë.

Në një intervistë të vitit 1977 me reporterin e BBC, Iain Johnstone, Eastwood shfaqej në një mjedis më ndryshe dhe me sjellje të tjera. I hareshëm dhe simpatik, aktori kishte pak ngjashmëri me protagonistin e ashpër dhe të ngurtë të vesternit të Sergio Leones.

Në fillim, kujtoi Eastwood, ai "nuk ishte shumë" i interesuar për t'iu bashkuar një filmi evropian me buxhet të ulët. Ai nuk ishte i panjohur në botën e vesternit, pasi në atë kohë luante në serialin e famshëm televiziv Rawhide. "Më pëlqeu [Një grusht me dollarë] dhe ndjeva se ndoshta një qasje evropiane do t'ia jepte një shije të re vesternit".

Ndonëse e cilësonin të duhur zgjedhjen e Eastwoodit, Leone fillimisht kishte në mendje James Coburnin. "Doja më shumë James Coburnin, por ai ishte shumë i shtrenjtë", tha regjisorin italian për BBC. Në atë kohë, Eastwoodi ishte opsioni më i

përballueshëm, duke kushtuar rreth 15 mijë dollarë (152 mijë dollarë ose 138 mijë euro më 2024) krahasuar me Coburnin me rreth 25 mijë dollarë (254 mijë dollarë ose 230 mijë euro më 2024). "Nuk e pashë asnjë karakter në serialin Rawhide, vetëm një figurë fizike", tha Leone. "Ajo që më preku më shumë tek Clinti ishte mënyra e tij e ngathët e lëvizjes. Më dukej se Clinti ngjante më shumë me një mace". Epikat e suksesshme që kishin mbretëruar gjatë Epokës së Artë të Holivudit, filluan të zbeheshin në popullaritet në vitet 1960. Leone, i cili në atë kohë ishte i mirënjohur për regjinë e filmave italianë me buxhet të ulët, vendosi të sfidonte veten me vesternin amerikan.

Rezultati ishte Një grusht me dollarë (i cili për herë të parë u dha në kinematë e Italisë me titullin Per un pugno di dollari), i cili ishte shumë më ndryshe nga filmat paraardhës të këtij zhanri. Bazuar në tregimin e samurajëve të Akira Kurosawas, Yojimbo, filmi u përqendrua te "Xhoi" që luhej nga Eastwoodi emocionalisht i ftohtë, i cili njihej si Njeriu pa Emër dhe i cili për të fituar para nxiti një luftë të bandave në qytetin meksikan të San Migelit. Filmi bashkoi një kastë dhe një ekip nga e gjithë ShBA-ja dhe disa vende evropiane. Siç tha Eastwood, filmi ishte "bashkëprodhim italo-gjermano-spanjoll i ribërjes së një filmi japonez në fushat e Spanjës".

"Unë i dija fjalët 'arrivederci' dhe 'buongiorno' dhe ai [Leone] dinte 'goodbye' dhe 'hello' dhe kjo ishte e tëra", tha Eastwood për BBC.

"Më pas ai mësoi pak anglisht, unë mësova pak italisht – dhe të dy pak spanjisht – dhe vazhduam tutje".

Aktorët i thoshin fjalët në gjuhën amtare, të cilat më pas dubloheshin në italisht dhe anglisht për audiencën përkatëse të filmit. Skenari përbëhej nga një "koncept italian se çfarë mund të jetë një zhargon i vesternit", tha Eastwood.

Kritikët italianë e panë filmin kur u dha premiera në Itali më 12 shtator 1964. Recensionet negative pasuan në vendet e tjera. "Sadizmi i filmit ishte fyes nëse nuk do të kishte të qeshura neutralizuese", shkroi kritiku britanik Philip French në "The Observer". Kur filmi u shfaq në ekranet në ShBA, në vitin 1967, komentet atje ishin të ngjashme. "Pothuajse klishe vesterni ... është film sintetik, jashtëzakonisht morbid, i dhunshëm", shkroi Bosley Crowther në "New York Times". Debutimi i filmit në ShBA u vonua për disa vjet sepse distributorët amerikanë kishin frikë se mos do të paditeshin nga Kurosawa, i cili kishte ngritur padi kundër Leones për kopjimin e Yojimbo-s.

Publikimi i vesternit inaugurues të Leones nxiti shfaqjen e vesternit all'italiana, një nënzhani i filmave të prodhuar në Itali, i cili në gjuhën e përditshme u bë i njohur si "spageti-vestern". Fjala "spageti" ishte nga përbuzja fillestare e kritikëve ndaj këtij realizimi ndërkombëtar.

"U desh pak kohë që Leone të ndikojë në filmat amerikanë,

sepse fillimisht kritikët përçmuan filmat e tij dhe të kolegut të tij Sergio Corbucci", thotë Mary Ann McDonald Carolan, profesoreshë dhe përgjegjëse e Studimeve Italiane në Universitetin e Ferfildit. "Spageti-vesterni u konsiderua si version me buxhet të ulët, ekzagjerim qesharak i vesternit të vërtetë".

Ndryshe nga homologët e tyre tradicionalë, spageti-vesterni u përqendrua te anti-heronjtë dhe merrej me paqartësitë morale. Xhoi i Eastwoodit nxiti konfliktin midis dy bandave rivale të kontrabandistëve, me qëllim të vjedhjes së thesarit të tyre; vetëm kur lëndohen njerëzit e pafajshëm, ai ndërhyr për të neutralizuar bandat. Spageti-vesterni kishte më shumë dhunë, ndonjëherë ndaj grave dhe fëmijëve. Sipas Carolanit, vesternët tipikë amerikanë lavdëruan shtrirjen drejt perëndimit dhe idealizuan Perëndimin e Egër, ndërsa spageti-vesterni përmbysi atë pikëpamje. Duke theksuar dhunën, këta filma ishin gjithashtu një kritikë ndaj dekadës së politikës së trazuar globale, veçanërisht në mes të Luftës së diskutueshme të Vietnamit.

Për shkak të pengesave gjuhësore gjatë prodhimit, dialogu u bë më i thjeshtë dhe më i rrallë, duke ndihmuar në shfaqjen e stilit të veçantë regjisorial të Leones. Skenat dhe partiturat muzikore mahnitëse nga kompozitori Ennio Morricone, u bënë marka të "spageti-vesternit" të Leones. "Filmat e mi janë në thelb filma pa zë", tha ai për BBC. "Dialogu

thjesht ia jep një peshë". Stili i tij ka jehonë në veprat e Quentin Tarantinos dhe Robert Rodriguezit, të cilët që të dy janë ndër regjisorët e mëdhenj të filmit që kanë përmendur ndikimin e Leones.

Një grusht me dollarë e transformoi Eastwoodin nga një aktor televiziv në një gjigant të ekranit të argjenditë. Ai vazhdoi të luajë në vazhdimet e trilogjisë, Për ca dollarë më shumë [For a Few Dollars More] dhe I miri, i keqi, i shëmtuari [The Good, the Bad and the Ugly].

"Ashtu si Jimi Hendrix që shkoi në Angli për t'u bërë i famshëm, tre vesternët që Eastwoodi bëri për Leonen, hapën karrierën e tij të shkëlqyeshme", thotë David Irving, regjisor dhe profesor i asociuar në Shkollën e Arteve të Universitetit të Nju-Jorkut. "Leone i dha jetë të re vesternit".

Pavarësisht kritikave të para, Një grusht me dollarë kishte shikues dhe u bë hit komercial në Evropë dhe në ShBA, duke fituar 14.5 milionë dollarë në nivel global. Vazhdoi të rritet në popullaritet në dekadën pas publikimit të tij dhe të ketë adhurues mes njohësve të kinemasë. Filmi ka vazhduar të frymëzojë veprat e tjera, në forma të shumta mediatike, nga filmat vizatimorë të videoljërës, si dhe regjisorët, ndërsa Leone pas vdekjes u nderua në Festivalin e 67-të të Filmit në Kanë, më 2014, kur Një grusht me dollarë u shfaq në natën përmbyllëse, duke treguar transformimin nga "një vestern i rrejshëm" drejt një klasiku të mirëfilltë. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sylvinho: Kjo humbje nuk ndryshon objektivat tona



TIRANË, 11 SHTATOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, në konferencë pas humbjes 0-1 me Gjeorgjinë, ka thënë ndeshja ishte shumë taktike dhe se barazimi do të ishte real. "Është ndeshje tjetër me Ukrainën e shumë ndryshe. Këtu kemi parë një ndeshje shumë taktike nga të dy. Duhet t'i bëj komplimente skuadrës së tyre dhe trajnerit të tyre që po punon shumë mirë. Sa i përket ndeshjes, fjala ishte ngadalësim, sa herë kishim topin, ata ktheheshin të gjithë mbara, të njëjtën gjë bënim ne. U bë ndeshje shumë taktike. Në fakt goli aty ndryshoi pak sipas meje se të dy skuadrat bënë mirë për barazimin. Për fat të keq, pësua gol, por ishte ndeshje e ndryshme nga ajo me Ukrainën. Zero gjuajtje në portë? Nuk jam i shqetësuar, futbollit është kështu. Kemi pritur një ndeshje të vështirë, Gjeorgjia është një ekip që ka mundur 4-1 Çekinë, e njohim. Kjo skuadër doli me Spanjën, mundi Portugalinë, është ekip i fortë. Ka lojtarë shumë të fortë në mesfushë. Një prej tyre është një lojtar mes 20 më të mirëve në botë, ka fituar titullin me Napolin", ka thënë trajneri i kuqezinjve, i cili më pas ka folur edhe për objektivat:

"Duhet të ecim para, është një grup i vështirë, por ne kemi fituar ndeshjen e parë, sot për fat jo. Por në tetor është gjithçka e hapur, të shohim çfarë ndodh, ne duhet të luftojmë deri në fund dhe në nëntor të shohim se çfarë ndodh. Objektivi është të mbetemi në garë në tetor dhe në nëntor në dy ndeshjet në shtëpi të mundohem të fitojmë grupin. Më duhet të shtoj që kur të mundemi, të provojmë situata, lojtarë, taktika, por sidomos lojtarë. Kur mundemi, po". "Mungesat? Unë nuk mund të ankojem, do t'u bëj komplimente lojtarëve, kemi bërë dy ndeshje të vështira, grupi është i vështirë, i ekuilibruar. Kjo është ndeshje fizike, nuk kam çfarë u them lojtarëve, ata kanë bërë maksimumin e mundshëm. Kjo është një ndeshje për barazim por, për fat të keq, kemi pësuar gol. Jam i lumtur me të gjithë lojtarët që kanë ardhur por, për fat të keq, më duhet të lija jashtë Zekën. Por e pashë lojtarin në stërvitje. Pas dëmtimit të Muçollit nuk kemi lojtar mëngjërashë ndaj erdhën Spahiu e Zeka. Asllani po rritet, ka bërë një Evropian të bukur. Ai ka një karrierë shumë të bukur para. Sa herë shihet një ndeshje

fitohet, thuhet nuk bëj asgjë, por po humbe... Hoxha e kam thënë që ndihet zhurma jashtë, kam folur me lojtarin. Por ka një kohë që lojtarit ka një rritje natyrale. Janë lojtarë të rinj. E kemi sjellë në mars, e bëri Evropianin që meritoi dhe e bëri mirë. Kur hyn në ndeshje bën mirë, pak nga pak po e kupton se nga fillimi është ndryshe. Ka kohë që duhet kaluar, është natyrale. Ai ka bërë një ndeshje të mirë, provoi 2-3 gjuajtje, por ata ishin të rreshtuar mirë, nuk ishte e thjeshtë për ne", ka deklaruar Sylvinho.

Trajneri Sylvinho ka folur edhe për Muçin, duket se nuk mund të inkuadrojë në lojë 12 lojtarë. "Muçi? Në vend të kujt? Nuk mund të luaj me 12 lojtarë. Muçi është një lojtar i fortë, ka bërë një transferim të Beshiktash, një rritje të pabesueshme. Është i fortë, por ne kemi shumë të tillë. Ndryshimi i vendit dhe ligës nuk është i thjeshtë. Ai është i rëndësishëm për ne, por në të ardhmen do të kthehet. Ai është i fortë. Unë preferoj të flas për 24 që kemi këtu. Ai është shumë i fortë, shumë i mirë, po përshtatet në Turqi e sigurisht që është një lojtar që do të kemi në objektivin tonë për tetorin", ka deklaruar Sylvinho.

SHKURT

Kuka: Distria po e vazhdon rrugëtimin drejt medaljes së tretë olimpike

Vetëm një muaj pas përfundimit të Lojërave Olimpikë "Paris 2024", Distria Krasniqi po vazhdon rrugën për medalje të tjera olimpikë. Puna për përgatitjet për Olimpiadën e radhës ka filluar. Këtë e ka bërë me dije vetë trajneri Driton Kuka përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Kuka ka shkruar se "Disi" do të vazhdojë të ndjek një tjetër medalje olimpikë. "Kampione dhe nënkampione olimpikë... Disi pas finales në Paris! Medalje e argjendtë me shkëlqim të artë. Disi po vazhdon rrugëtimin drejt LA 2028. Duke ndjekur medaljen e tretë olimpikë", ka shkruar Kuka. Kujtojmë se Distria ka dy medalje olimpikë në "LO Tokyo 2020" të artën dhe "LO Paris 2024" të argjendtën.

Kvaratskhelia: Shqipëria është skuadër e fortë, por ne e merituar fitoren

Kombëtarja e Shqipërisë ka pësuar humbje nga Gjeorgjia (0-1). Pas lojës, ylli gjeorgjian Khvicha Kvaratskhelia ka thënë se Shqipëria është një skuadër e fortë, por se Gjeorgjia e meritoi fitoren. "Jam i lumtur për golin pavarësisht se kush shënon, rëndësi ka fitorja. Shqipëria është skuadër e fortë, mendoj se e merituar të fitonim. E kemi fituar shumë mirë, 2 ndeshje, 2 fitore. Grupi është i fortë. Duhet të vazhdojmë të luftojmë", ka thënë Kvaratskhelia në "TV Klan". Ai vlerësoi se u markua mjaft mirë nga mbrojtja "Kuç e Zi", por rëndësi ka fitorja.

Dy yjet e Kosovës në formacionin e xhiros në Ligën e Kombeve

Ka përfunduar xhiroja e dytë në Ligën e Kombeve ku kësaj radhe Përfaqësuesja e Kosovës ka fituar dhe ajo e Shqipërisë ka pësuar humbje. "Dardanët" triumfuan në udhëtim të Qipro me rezultat 4-0, derisa kuqezinjtë u mposhtën fatkeqësisht në "Air Albania" nga Gjeorgjia me rezultat minimal 0-1. "SofaScore" ka publikuar edhe formacionin më të mirë të xhiros së dytë, ku kanë zënë vend edhe dy futbollistët e Kosovës përkrah shumë yjeve të mëdha. Në portë është maqedonasi Dimitrievsk, derisa mbrojtja përbëhet nga Trent Alexander Arnold, ylli kosovar Lumbardh Dellova, suedezi Gudmundsson si dhe anësori fantastik i Kosovës, Donat Rrudhani. Në mesfushë janë Luka Modriq, Bruno Fernandes dhe Kerem Akturkoglu, derisa treshja e sulmit përbëhet nga Harry Kane, Benjamin Sesko dhe Viktor Gyokeres.

Rubin Kazani i kërkon 10 milionë euro për Dakun

Fillimisht ishte fjala se nuk do të largohej shpejt nga ekipi. Mirlind Daku është padyshim një hero të Rubini i Kazanit, veçse edhe heronjtë e kanë një çmim, dhe për sulmuesin kuqezinjtë ka interesim. Mediet ruse informojnë se klubi i Krasnodarit planifikon ta marrë 26-vjeçarin nëse shet sulmuesin kryesor të ekipit, Xhoni Kordoba. Këtë e thotë gazetari rus Ivan Karlov. Babai i futbollistit kosovar deklaroi disa ditë më parë se djali i tij nuk do ta braktisë tani shpejt Rubinin, por transferimi mund të ndodhë në janar. Besohet se Rubini do të kërkojë rreth 10 milionë euro për kartonin e sulmuesit të kombëtares shqiptare, dhe ky do të ishte një përfitim i madh për klubin. Kjo sepse Rubini e mori Dakun vetëm për 1.2 milion euro nga Osijeku i Kroacisë. Sulmuesi kuqezinjtë është futbollisti më i mirë i ekipit të trajnerit Rahimov, duke pasur 5 gola dhe 3 asistime në 7 ndeshje të Premierë Ligës së Ruisë, ndonëse për momentin është i dëmtuar. Ai nuk është grumbulluar në kombëtare në ndeshjet e Ligës së Kombeve tani në shtator.

Ajeti nga Cluji kalon te Bodrumspor

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Arlind Ajeti, e ka lënë Rumaninë dhe është transferuar në kampionatin turk. Mbrojtësi kuqezinjtë u largua nga Cluj dhe u prezantua te Bodrumspor, ku së fundmi ka kaluar edhe Taulant

Seferi. Ajeti u ble për 300 mijë euro nga klubi turk dhe u prezantua me një video spektakolare. "Klubi ynë ka arritur marrëveshje trevjeçare me mbrojtësin Arlind Ajeti, i cili sezonin e kaluar luajti për CFR Cluj. Mirë se erdhe në familjen tonë,

Arlind!", shkruhet në njoftimin e klubit turk. Për lojtarin 30-vjeçar mund të konsiderohet një hap i rëndësishëm në karrierë në këtë moment, pas aventurave që ka pasur në Zvicër, Itali, Danimarkë dhe së fundi në Rumani.

Norrisi, mesazh Verstappenit: Po rikuperojmë hap pas hapi, tani besojmë edhe më shumë te titujt

LONDËR, 11 SHTATOR - Lando Norris ka rikuperuar diçka në renditje ndaj Max Verstappenit pas garës së Monzas, por kjo nuk mjafton. Piloti britanik i McLarenit synon të bëjë një hap më të madh në garën e Bakus, që zhvillohet këtë fundjavë në Azerbajxhan. "Ishte fantastike

ta përfundojta garën e fundit evropiane në podium për të 12-ën herë me radhë. Unë dhe inxhinierët e mi analizuam paraqitjen tona në Monza dhe gjetëm mënyra për t'u përmirësuar si nga ana ime ashtu edhe si ekip", u shpreh Norris. "Qëllimi ynë është i qartë. Kam besim të

plotë te ekipi për ta vazhduar punën dhe përmirësimin. Tani që dy kampionatet janë të hapur ne jemi më të vendosur se kurrë. Jam krenar për ekipin dhe mezi pres të shoh se çfarë mund të bëjmë këtë fundjavë", ka shtuar britaniku. "Mezi pres të kthehem në Azerbajxhan.

Unë jam optimist për atë që mund të bëjmë, duke marrë parasysh makinën që kemi. Përditësimet kanë funksionuar mirë dhe kemi grumbulluar më shumë pikë se Red Bulli në çdo garë. Shpresojmë që kjo fundjavë të mos jetë ndryshe", ka deklaruar Norrisi.



Përfundon faza e parë e implementimit të programit 'Futbolli për shkolla'

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ka përfunduar faza e parë e implementimit të programit "Futboll për shkolla", i cili është një projekt i menaxhuar nga FIFA. Për tri ditë rresht arsimtarë të edukatës fizike dhe trajnerë nga pesë regjione të Kosovës kanë ndjekur mësimet teorike dhe trajnimet praktike që i parasheh ky program.



Projekti "Futbolli për shkolla", që ka për synim bazë masivizimin e futbollit me anë të fëmijëve të shkollave fillore, tashmë ka arritur shtrirjen në 5 regjione të Kosovës. Në muajt në vazhdim do të ketë rritje edhe në komunat e tjera. I pari i FFK-së, Agim Ademi, u shpreh i lumtur me faktin që FIFA ka vendosur që këtë projekt ta sjellë në Kosovë, në vendin ku ka numër të madh të rinjve. "Futbolli për shkolla" është një projekt shumë i mirë dhe falënderoj FIFA-n dhe deleguesit e saj që kanë ardhur në këtë eveniment në Kosovë. Edhe për ne si FFK, edhe për FIFA-n, ky është projekt shumë i rëndësishëm, pasi që në fillim të zhvillimit të tyre orienton që të bëhen sportistë dhe njerëz të mirë të shoqërisë. Ky projekt përputhet me strategjinë dhe projektet e FFK-së, masivizimin e futbollit dhe me nxjerrjen e talentëve që në moshë të hershme. Falënderoj shumë edhe të gjitha komunat që kanë

treguar gatishmëri për bashkëpunim, nxënësit dhe shkollaret pjesëmarrës", ka thënë Ademi. "Futbolli për shkolla" cilësohet si projekt shumë i rëndësishëm edhe për komunën e Prishtinës, si partner në këtë projekt. Drejtori i Drejtorisë për Sport në këtë komunë, Kushtrim Mushica, u shpreh shumë mbështetës për këtë nismë duke e rikonfirmuar mbështetjen e kësaj komune. "Projekt shumë i qëlluar. Ky projekt ka përkrahjen e drejtorit të Sportit në komunën e Prishtinës, sepse lidhet me politikën që ka kjo drejtori, pra masivizimin e sportit. Ky projekt, që ka për qëllim masivizimin e futbollit në shkolla, është fillimi i çdo gjëje për zhvillimin e tyre sa më të mirë, që të përgatiten edhe për jetën, edhe nëse nuk përfundojnë si futbollistë profesionalë", u shpreh Mushica. Puna me arsimtarët dhe me trajnerët e Kosovës ka lënë mbresa

të mëdha te përfaqësuesit e FIFA-s, të cilët ishin të impresionuar me profesionalizmin dhe angazhimin e tyre.

Melvin Mendy, koordinator i projektit "Futbolli për shkolla" nga FIFA, duke u shprehur që projektin po e lënë në duar të sigurta, ndër të tjera, tha: "Ishte një përvojë shumë e mirë. Në këto tri ditë ishim shumë me fat që kishim një ekip të mirë të arsimtarëve, të cilët ishin shumë kompetentë dhe të gatshëm për të mësuar. Ata ishin zgjedhur me shumë kujdes nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe nga komunat. Ata janë të vetdijshëm për përgjegjësinë që kanë për të mësuar këtë program dhe për mësuesit e tjerë në Kosovë. Angazhimi i tyre ka treguar shumë premisa pozitive për të ardhmen e projektit. Ne gjithmonë themi që, kur largohemi nga një vend, këtë program e lëmë në duar të mësuesve. Këtë herë ndihemi veçanërisht të sigurt që ta lëmë programin në duar të tyre, sepse jemi të bindur që ata do të bëjnë një punë të shkëlqyer". Ky projekt, krahas pjesës praktike në fushë, ka një aplikacion digjital me anë të të cilit do të përcillen të gjitha aktivitetet dhe zhvillimi i projektit, përkatësisht fëmijëve në çdo shkollë, duke kontribuar në zhvillimin e fëmijëve si individë të mirë për shoqërinë.

Kane regjistron 100 ndeshje me Anglinë: Ishte natë e përkryer

LONDËR, 11 SHTATOR - Anglia fitoi 2-0 ndaj Finlandës në Ligën e Kombeve, por protagonist i këtij takimi ishte sulmuesi Harry Kane. Në ndeshjen e 100 me fanellën e kombëtares së "Tre Luanëve", ai realizoi dy gola. "Kur isha i huazuar te Millwalli, Norwichi apo Leicesteri, as që mendoja se do të arrija të luaja 100 ndeshje me kombëtaren", ka thënë Kane, të cilit iu bë një dhuratë e veçantë për këtë arritje nga ish-mesfushori anglez Frank Lampard. "Që në moshë të re, nga dyshimi për ta vazhduar futbollin dhe më pas për të bërë atë që kam bërë, thjesht mendoj se kjo më ka ndihmuar që të jem i fokusuar dhe i motivuar në



stërvitje dhe ndeshje", ka shtuar sulmuesi i Bayern Munchen. "Në përgjithësi, në ditët e sotme, si futbollist ne marrim kritika, kemi njerëz që flasin për ne si lojtarë. Unë gjithmonë kam folur kur gjërat nuk po shkojnë ashtu si duhet, për t'u motivuar dhe sjellë një energji dhe uri brenda jush që

të luaj më mirë", ka deklaruar sulmuesi anglez. "Ishte mbrëmja e përkryer për të shënuar në ndeshjen e 100. Në tetor do të jem gati të shënoj përsëri për kombëtaren, përpiqem të mos vendos kufij për atë që mund të arrij", ka shtuar Kane, i cili është golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve të Anglisë me 68 gola. "Unë e di se duke luajtur në këtë ekip do të kem shanse të shënoj shumë gola. Do të vazhdoj për aq kohë sa të mundem dhe kush e di se çfarë mund të arrijmë. Disa nga lojtarët më të mirë në botë kanë shënuar më shumë se unë, kështu që ka objektivat atje për të provuar dhe arritur", u shpreh Kane.

SHKURT

Nagelsmann: Jam i kënaqur, kemi ide sulmuese

Gjermania barazoi me Holandën 2-2 në Ligën e Kombeve, por trajneri Julian Nagelsmann është shprehur i kënaqur, sidomos me faktin se futbollistët e tij kanë ide sulmuese. "Jam i kënaqur me punën e bërë këto ditë. Barazimi këtu mund të qëndrojë. Ne kemi ide sulmuese, lojtarët besojnë në aftësitë e tyre. Sigurisht nuk jemi ende aty ku dëshirojmë, për të përputhur dominim me rezultat, por nëse do të jemi të qëndrueshëm rezultatet do të vijnë. Ne duhet të ecim përpara", ka deklaruar Nagelsmann.

ShBA-ja zyrtarizon trajnerin Pochettino

Flitej prej kohësh, por tashmë është zyrtarë: Mauricio Pochettino është trajneri i ri i përfaqësueses së ShBA-së. Ish-trajneri i Tottenham Hotspurit, PSG-së e Chelseat, pranoi ofertën e bordit drejtues për të Federatës Amerikane për ta drejtuar ekipin kombëtar në Botërorin e 2026-s që do të zhvillohet në shtëpinë e tyre. Në prezantimin e Pochettinos, drejtuesit e federatës u shfaqën shumë të lumtur që një trajner me kaq shumë përvojë sa Pochettino pranoi ofertën e tyre.

Parisi nis të normalizohet pas përfundimit të Olimpiadës

Pas përfundimit të Lojërave Paraolimpike "Paris 2024", në kryeqytetin francez ka nisur heqja e instalimeve dhe strukturave të përkohshme të lidhura me këtë event. Puna më e madhe po kryhet në veçanti në qendër të qytetit, por edhe në mjaft zona të tjera përreth kryeqytetit francez. Pritet që punimet për "lirimin" e ambienteve të përfundojnë deri në fund të tetorit. Kjo është ajo që u raportua sot nga drejtori ekzekutiv i komitetit organizativ të Lojërave Olimpikë "Paris 2024", Edouard Donnelly, në një konferencë shtypi. Disa vende, si ai i golfit në Saint-Quentin-en-Yvelines ose stadiumi i Lille që priti basketbollin, janë kthyer tashmë identike me periudhën para-olimpikë.

Mbappe kishte marrëveshje me Liverpoolin

Kylian Mbappe tanimë është futbollist i Real Madridit, por janë zbuluar prapaska të reja të para dy viteve. Sipas "L'Equipe", një burim francez i nivelit të parë, Mbappe, pothuajse iu bashkua Liverpoolit në vitin 2022. Kjo ishte menjëherë pas zgatjes së kontratës së tij për të qëndruar në PSG deri në vitin 2024, por u ndje i "tradhtuar" nga klubi. Ai thuhet se kërkoi të largohej nga klubi në atë kohë dhe kishte një marrëveshje verbale për t'u bashkuar me Liverpoolin. Natyra e marrëveshjes ishte e tillë që ai do të lejohej të bashkohej me klubin e tij të ëndrrave Real Madrid në të ardhmen. "The Reds" kishte bërë një ofertë fillestare me vlerë 200 milionë euro, e cila Mbappe besonte se do të pranohej. Me sa duket, drejtori sportiv i PSG-së në atë kohë i kërkoi Liverpoolit të kthehej me më shumë para për të pasur edhe një shans për të nënshkruar me Mbappen, i cili tani luan për Madridin. Por gjiganti anglez nuk ofroi më shumë dhe transferimi i tij në "Anfield" dështoi.

Zhgenjejnë Brazili dhe Argjentina

Kanë dhuruar surpriza të mëdha ndeshjet kualifikuese të Amerikës së Jugut për Kupën e Botës 2026. Argjentina dhe Brazili humbasin ndeshjet respektive në transfertë

përkatësisht kundër Kolumbisë dhe Paraguit. Kampionët në fuqi të botës mundën 2-1 nga Kolumbia. Shënori Nico Gonzalez për argjentinastit, por goli i

Mosqueras dhe penalltia e shënuar nga James Rodriguez u japin tri pikë kolumbianëve. Paragui mundi minimalisht 1-0 "selecao" falë golit të shënuar nga Gomezi.

Vetëm një barazim pa gola 0-0 për Uruguain në Venezuelë, Bolivia dhe Ekuadori mundën respektivisht Kilin (2-1) dhe Perunë (1-0). Pas 8 ndeshjeve të luajtura

Argjentina vazhdon të qëndrojë në vendin e parë me 18 pikë, e ndjekur nga Kolumbia, Uruguai dhe Ekuadori. Brazili qëndron në vendin e 5-të në kuotën e 10 pikëve.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “E.M.S” Sh.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811869017 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “E.M.S” D.O.O. od Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811869017 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “E.M.S” L.L.C. with headquarters Obilq, has come to the decision to quit its business: 811869017 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Austrian Institute of Excellence” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810971954 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Austrian Institute of Excellence” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810971954 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Austrian Institute of Excellence” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810971954 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lulvera Jashari shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Xheladin Deda”.

- Resmije Rama shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore Xhevat Jusufi ish shkolla fillore “Rifat Vidishiqi”.

- Qerfime Rama shpal te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Xhevat Jusufi” ish shkolla fillore “Rifat Vidishiqi”.

- Bedrije Deliu shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme “Frang Bardhi”.

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari”.

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L